



Trajneri i Lacit Stavri Nica u shpreh i kenaqur qe skuadra e tij arriti nje fitore te rendesishme ndaj Tiranës, por ne plan te pare per te eshte shendeti i lojtarit te demtuar Zefi. “E kishim vlersuar maskimalisht ndeshjen me Tiranën e arritem te realizonim objektivin tone qe ishte fitorja, e cila kalon ne plan te dyte ne keto momente pasi vemendja jone eshte e fokusuar tek demtimi i Zefit qe la fushen e lojes pas nje dyluftimi me Semedon. Sigurisht duhet ta kishim zgjidhur ndeshjen me pare pasi i kishim mundesite por rendesi kane tri piket”, prefundoi prononcimin e tij pasndeshjes trajneri Nica